Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec

**Drejtoria Për Mbrojtje dhe Shpëtim**
Odelenje za Zastitu i Spasavanje
Department for Protection and Rescue

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot / Br. prot. 1386 Më / Dt. 26.04.2019
RAHOVEC - ORAHOVAC

# RAPORTI 3 MUJOR I PUNËS

# JANAR-MARS 2019

Gjatë këtij 3 mujori ne si drejtori kemi pasur aktivitete si më poshtë:

- Gjatë muajit Janar si drejtor kam qenë i angazhuar në menaxhimine kontratës për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve, së bashku me kompanitë e kontraktuara nga komuna kemi qenë tërë kohën në terren,në çdo vendbanim të gjitha rrugët primare dhe sekondare janë pastruar me kohë dhe nuk është krijuara ndonjë problem në qarkullimin e lirë të automjeteve dhe këmbësorve.

- Në sektorin e zjarrfiksave ne muajin Janar një rast që vlen të përmendet është shpërthimi i bombolës së gazit në një nga qebaptoret në fshatin Ratkoc, nga ky shpërthim fatmirësisht nuk ka pasur viktima por vetëm ka të lënduar dhe dëme material.

- Është djegur shtëpiza turistike që ka qenë e ndërtuar në vendin e quajtur "Epopeja e Rahovecit", zjarrfikësit kanë intervenuar me kohë por fatkeqësisht nuk kanë mundur të e lokalizojnë zjarrin, poashtu në vendin e ngjarjes menjëherë është paraqitur edhe inspektori për mbrojtje nga zjarri.

- Po vazhdojnë punët në ndërtimin e garazhës mbrapa objektit të zjarrfiksave, shumica e punimeve kanë përfunduar kanë mbetur edhe disa pozicione të vogla që të përfundohen.

- Janë inspektuar lumenjtë, përockat dhe kanalet e hapura dhe pas inqizimit të gjendjes në terren I kemi propozuar drejtorive përkatëse për trajtim të kanaleve të bllokuara, pastrim të përockave etj.

- Përmes zyrës së prukurimit është nënshkruar kontrata për servisim të aparateve kundër zjarrit, kompania momentalisht po vazhdon me servisimin e aparateve.

- Është nënshkruar kontrata për grantin e fituar nga Zyra Japoneze në Prishtinë në vlerë prej 75.250 euro, ky grant do shpenzohet në blerjen e një kamioni modern për zjarrfikje.

- Kemi pritur në takim zjarrfikësit nga Franca, nga ata morrëm konfirmimin se brenda muajit Qershor do i dhurojnë njësisë sonë një kamion të zjarrfikjes me vegla paisje poashtu dhe uniformat për intervenim.

- Angazhim të rregullt në këshillin komunal për siguri në bashkësi.

- Si drejtor poashtu kam qenë i angazhuar në menaxhimin e kontratës për mirëmbajtje të ndriqimit publik, gjatë këtij 3 mujori kemi arritur të intervenojmë në çdo vendbanim të komunës ku ka pasur probleme me ndriqim publik.

- Kemi pasur takime të vazhdueshme me FSK-në, kemi arritur të dakordohemi që brenda muajit qershor FSK së bashku me njësit lokale emergjente dhe ato të sigurisë të organizojë një ushtrim fushor në komunën tonën tonë.

| 2019 | Zjarre në Objekte ndërtimore | | | | | | | Zjarre në Objekte ekonomike | | | | Zjarre në Pajisje elektrike | | | | Zjarre në siperfaqe të hapur | | | | | Zjarr në Auto: | Gjith. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Banesa / shtëpi | Objetke ndimse | Plevica - Shtalla | Objekte kolektive | Oxhaqe | Mbeturina | Zjarre te rrejshme | Publike | Objekte Biznesi | Objekte Industriale | ushqim bagtije | Pajisje elektrike | Paisjet shpërndarse | Gjeneratora | Sherbime | Mali | Bari I that | Sipërfaqe bujqësore | Vershime | Intervenime Teknike | Automjete Motorike | |
| Janar | 1 | | | | 1 | 1 | | | | | | | | | | | 1 | | 1 | | | 5 |
| Shkurt | | 2 | | | | 1 | | | | | | | 1 | | 4 | 1 | 12 | | | | | 21 |
| Mars | 2 | | 1 | | 1 | 2 | 1 | 2 | 2 | | | 1 | | | | 26 | 28 | | | | 2 | 68 |
| Prill | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Maj | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Qershor | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Korrik | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Gusht | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shtator | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Tetor | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Nentor | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Dhjetor | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Gjithsejë | 3 | 2 | 1 | 0 | 2 | 4 | 1 | 2 | 2 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 4 | 27 | 41 | 0 | 1 | 0 | 2 | 94 |